



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Patos, më ___/ 12/ 2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjesë këmbimi për mjetet”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34330000-9 -
Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,860,600 (nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind)
lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe
miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me
përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/
kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika
5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP dhe ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 20 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohej të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

OSE

Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Katalogë/skedë teknike, vetëm për pjesët e këmbimit të mjeteve tip kamion Tatra T-815, IFA W-50, autobot tip Renault, Mitsubishi L200, sipas tabelës së publikuar në shtojcën nr.6.

Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të artikujve që janë objekt i prokurimit për mjetet si më sipër me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në

katalogun/et/skedat e paraqitur te shenohen ne menyre te dukshme te gjitha llojet e pjeseve te kembimit te kerkuara nga AK. (Pjeset specifike te katalogut/skedës teknike ku jepen karakteristikat e mallit qe ofertohet nqs nuk jane ne gjuhen shqipe te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se malli i ofruar është ne përputhje me specifikimet teknike të kërkuara

2.3.3. Ofertuesi te paraqese, perpara afatit te fundit per hapjen e ofertave nga një moster fizike cope/set të pjesëve të këmbimit përfaqësuese për AK. Mostrat do të paraqiten së bashku me listën përkatëse të mostrave të protokolluar prane zyres se protokollit te Albpetrol sha. Mostrat që kërkohen janë si më poshtë:

Depresor ajri për mjetin tip TATRA-815 1(nje) set.

Kit freksioni për mjetin tip TATRA-815 1(një) set

Jastëk ajri për mjetin tip autobot RENAULT 1(një) copë

Pompe grupi timoni per mjetin tip MITSUBISHI L200 1(një) copë

Kit freksioni për mjetin tip MITSUBISHI L200 1(një) set

Grup freni dore per mjetin tip IFA W-50 1(nje) cope

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6 germa a, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter ndihmon AK ne vleresimin sa me te drejte nga ana teknike te mallit te ofruar dhe sherben gjithashtu per te vertetuar nese malli i ofruar eshte ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara dhe ploteson kerkesat e AK.

2.3.4. Certifikatë ISO 9001:2015 ose te perditesuar (per sistemet e menaxhimit te cilesise), ose ekuivalente, te operatorit ekonomik ofertues, leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë dhe ky kriter i vendosur është në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës pranë Autoritetit Kontraktor të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit. *Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Njësia e Prokurimit: